

Klodian Mene mban pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë së Tregut të Brendshëm në Drejtorinë e Përgjithshme të Politika të Zhvillimit Ekonomik, Nxitjes së Biznesit dhe Çështjeve të Tregtisë Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.

Ka përfunduar studimet në Drejtësi në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës nga në 2005 dhe i lincësuar me Licencë Avokatie nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë, duke u treguar i aftë në fushën ligjore.

Në qershor 2018 deri më mars 2023 ka mbajtur rolin e Drejtorit të Drejtorisë së Privatizimit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, nga ku më pas ka mbajtur të njëjtin pozicion në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, duke treguar vazhdimësi dhe përkushtim në sektorin publik.

Më herët, Pjesëmarrja në Këshillin Mbikëqyrës të “OST” SH.A dhe anëtarësia në Këshillin Mbikëqyrës të “Albkontroll” Durrës SH.A. si kryetar për një periudhë të gjatë, tregojnë angazhimin e tij për të garantuar transparencën dhe efikasitetin në administratën publike. Më tej, ka shërbyer si kryetar i Komisionit të Provimeve të Aftësive Profesionale për Bordin e Mbikëqyrjes Publike (BMP) nga Prilli 2018 deri në Prillin 2019, duke kontribuar në rritjen e standardeve të aftësive profesionale në sektorin publik.

Në 2013 deri më 2018 ka qenë përgjegjës në Sektorin e Privatizimit të Shoqërive Publike e Tregtare, ku ai ka punuar në proceset e privatizimit dhe menaxhimin e aseteve të shtetit. Pjesëmarrja e tij si anëtar i Autoritetit të Regjistrimit të Ekspertëve Kontabël dhe si anëtar i Njësisë së Zbatimit të Projekteve për Tirana International Airport (TIA) dëshmon për njohuritë e tij të thella dhe angazhimin për zhvillimin ekonomik.

Duke filluar karrierën e tij profesionale në vitin 2006, ai ka mbajtur pozita të ndryshme në administratën publike, duke kontribuar në inspektimin e minierave dhe si jurist në Komisionin Qeveritar të Tokës. Ai ka shërbyer gjithashtu si përgjegjës i Zyrës Juridike në “Alb Miniera” SH.A. për një periudhë të shkurtër, duke i dhënë një dimension të rëndësishëm ligjor dhe administrativ karrierës së tij.